



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 73/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me zyrtaren ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dhe Gradanska Inicijativa Serpska Lista, dega në Graçanicë, për shkak të vendosjes së posterve në objekt publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

LEJOHET tërheqja e ankesës të paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, Anr. 73/2017, e datës 05.06.2017.

A r s y e t i m

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjekteve politike Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dhe Gradanska Inicijativa Serpska List, për shkak të vendosjes së posterëve në objekt publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pasi që ankesa ka qenë e paqartë, PZAP-i ka kërkuar nga parashtresuesi i ankesës që të bëjë plotësimin e ankesës dhe të bëjë identifikimin e objektit për të cilin bëhet fjalë.

Me datë 06.06.2017, ankuesi ka parashtuar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër Anr. 73/2017, duke arsyetuar se objekti në fjalë është pronë private.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 73/2017 më datën 07.06.2017



Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haziri